

ZBULONI BUKURINË E TIJ NË 7 MINUTA

Pjesa 5 nga 7

**Dr. Naxhi IBRAHIM**

# **EMRAT E TIJ TË BUKUR**

Përktheu: Laureta Rexha

Redaktoi: Dr. Sedat Islami

**AUTOR: DR. NAJI IBRAHIM/ EDITOR: ANN RONAYNE/ DIZAJNI: DR. WASEEM RIAZ**

# EMRAT E TIJ TË BUKUR

## EMRAT E BUKUR TË ZOTIT (ALLAHUT)

Kurani i Madhërishëm dhe Profeti Muhamed na mësojnë për emrat e Allahut, të vetmit Zot të vërtetë. Për shembull, Kurani i Madhërishëm thotë: *“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrni Atë (lutjuni Atij) me to...”* (7:180)

Kur i lutemi Allahut, jemi të inkurajuar që ta thërrasim Atë me emrat e Tij të bukur apo me ndonjë emër të përshtatshëm me kërkesën apo nevojën tonë që kemi. Për shembull, nëse kërkesa jonë lidhet me furnizim, ne mund ta lusim atë me emrin Rrezak, që është Furnizuesi. Këta emra nuk tregojnë se Allahu është më shumë se një qenie e vetme; ata janë emrat që i përshkruajnë cilësitë e ndryshme që i përkasin Zotit të vetëm të vërtetë, Allahut.

Ne njerëzit asnjëherë nuk mund ta kuptojmë madhësinë e Allahut, por sa më shumë që e njohim Atë dhe atë që e kënaq atë, aq më shumë do ta duam dhe do ta adhurojmë Atë. Të mësuarit rreth Allahut -përmes studimit dhe kuptimit të emrave dhe cilësive të Tij- na sjell qetësi shpirtërore në këtë jetë dhe në tjetrën sepse e kuptojmë që gjithçka është në duart e Tij dhe ndodh sipas Vullnetit të Tij absolut.

Nuk është e preferuar që një njeri të ketë një emër që i përket vetëm Allahut. Muslimanët shpesh ndodh që kanë emra që fillojnë me Abd (që d.m.th. ‘rob i’), përcjellë nga një prej emrave të Allahut. Kështu, Abdullah domethënë ‘rob i Allahut’, ‘AbduRrahman’ domethënë ‘rob i të Gjithëmëshirshmit’, dhe kështu me radhë.

**Err-Rrahim**-Mëshirëbërësi. Përderisa ne nuk mund t’i afrohemi mëshirës së Tij, ne mund ta vlerësojmë atë dhe të mundohemi më së miri të jemi të mëshirshëm ndaj të tjerëve. Duke mësuar më shumë rreth emrave të Zotit tonë të vërtetë (Allahut) dhe duke besuar singlerisht në Të dhe në cilësitë e Tij, na bën që ne gjithmonë ta kemi në mendje se sa herë që bashkëveprojmë me të tjerët, Allahu është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërësi, Më i Dhembshuri, Më i Mëshirshmi, Gjykuesi, i Gjithëdijshtmi, Shikuesi, Falësi, Më i Buti, i Vërteti, etj...

Është me rëndësi që ne këta emra dhe cilësi të Allahut t’i vëmë në praktikën e jetës tonë, në atë masë që natyra jonë njerëzore dhe kapaciteti ynë e pranojnë.

Tani le të mësojmë më shumë rreth emrave të Allahut.

## **Es Selam (Paqësori)**

Burimi i paqes dhe përsosmërisë, i cili është i pastër nga çdo e metë. Ai është pa të meta;  
Ai nuk ka veçori njerëzore sikurse të qenët i sëmurë, i uritur, i etur apo të pasurit ftohtë.

## EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT

Disa nga emrat e Allahut në gjuhën arabe dhe kuptimet e tyre në gjuhën shqipe:

|                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Allah:</b>       | Emri kryesor i Zotit të vetëm të vërtetë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Err Rrahman:</b> | I Mëshirshmi, Mëshirëbërësi dhe me i Dhembshuri, i cili i mëshiron të gjitha krijesat.                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Err Rrahim:</b>  | Mëshirëbërësi. Edhe pse ne nuk mund të jemi asnjëherë të mëshirshëm sa Ai, ne mund ta çojmë atë dhe të mundohemi sa më shumë që të jemi të mëshirshëm ndaj të tjerëve.                                                                                                                                                                       |
| <b>El Malik:</b>    | Sunduesi, i cili ka autoritet mbi të gjithë qiejt dhe tokën.                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>En Nur:</b>      | Burimi i dritës. Drita përmes të cilës ndriçohemi dhe na udhëzon. Në një kaptinë të quajtur Nur, Kurani na tregon se <i>“Allahu është drita e qiejve dhe e tokës”</i> . (24:35)                                                                                                                                                              |
| <b>El Kuddus:</b>   | I Pastërti: I Shenjti, i Pastërti, i Bekuari.                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Es Selam:</b>    | Paqësori, burimi i paqes dhe përsosmërisë, i cili është i pastër nga të metat. Ai është gjithnjë perfekt; Ai nuk ka veçori njerëzore sikurse sëmundja, uria, etja apo të ftohtit.                                                                                                                                                            |
| <b>Err Rrezak:</b>  | Furnizuesi, i cili ofron furnizim, siguri dhe udhëzim për çdo qenie të gjallë. Secili nga ne do të arrijë furnizimin që është i caktuar për ne, por ne duhet të punojmë për ta fituar atë, natyrisht, përmes rrugëve të lejuara dhe jo përmes mashtrimit dhe korrupsionit.                                                                   |
| <b>El Besir:</b>    | Shikuesi, që sheh gjithçka që ndodh në univers.                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Es Semi:</b>     | Dëgjuesi, që dëgjon gjithçka. Kur ne e thërrasim apo e lutim atë, Ai na dëgjon.                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>El Adhim:</b>    | I Madhi, që është më i madh se çdo gjë apo çdokush në gjithë krijesat e Tij.                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>El Gafur:</b>    | Falësi, që fal gjithmonë ata që janë penduar dhe kthyer kah Ai.                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Et Tevvab:</b>   | Ai që e pranon pendimin. Allahu do që mëkatarët të pendohen tek Ai dhe në vazhdimësi e mirëpret dhe e pranon pendimin tonë të singertë. Në të kundërtën, qeniet njerëzore, edhe ato që janë më të afërtat me ne, eventualisht, lodhen nga pranimi i gabimeve tona dhe nga dhënia e mundësive edhe një herë të dytë me të njëjtin entuziazëm. |
| <b>El Alij:</b>     | I Larti, Madhështori, që është lart mbi krijesat e Tij.                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

- El Vedud:** Më i Dashuri, që i do ata që janë të drejtë dhe të dëgjueshëm dhe dashuria e të Cilit manifestohet te ne në jetën e përditshme. Ne duhet të jemi mirënjohës për dashurinë e Tij dhe t'i duam të tjerët duke dëshiruar për ta atë që duam për vete
- El Hakim:** I Urti, gjykimi i të Cilit është skajshmërisht i drejtë dhe nuk mund t'i iket.
- El Alim:** I Gjithëdijsmi, që e di atë që shihet dhe atë që është e fshehur në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. *“Asnjë gjeth nuk bie pa dijen e Tij.”* (6:59).
- Err-Rreuf:** Më i Buti, butësia, mëshira dhe dhembshuria e të Cilit janë të pafundme.
- Err-Rrezak:** Furnizuesi, Ai që jep furnizim, siguri dhe udhëzim për çdo krijesë të gjallë. Secili nga ne do ta marrë furnizimin që e kemi të caktuar, por ne duhet të punojmë për të, natyrisht, përmes rrugëve të lejuara dhe jo përmes mashtimit dhe korrupsionit.
- El Hak:** I Vërteti, Zoti i vetëm i vërtetë, fjalët e të Cilit janë të vërteta. Duke e ditur se Ai është e kundërta e gënjeshtërs, ne duhet të mundohemi që ta zbulojmë dhe ta zbatojmë të vërtetën në çdo gjë, fjalë apo vepër, edhe nëse ajo e vërtetë është pro apo kundër nesh.
- El Halim:** Afatizuesi, Ai që është i qetë, i durueshëm dhe asnjëherë nuk ngutet, madje as me mëkatarët, keqbërësit dhe ata që e mohojnë apo nuk e besojnë Atë. Allahu i tejkalon gabimet tona, ndaj ne duhet të mundohemi të bëjmë të njëjtën gjë me ata rreth nesh sepse në realitet ata që mbajnë hatër me të tjerët vetëm se i bëjnë dëm vetvetes.
- El Mugjib:** Përgjigjedhënësi, Ai që u përgjigjet lutjeve tona. Allahu do që ne ta lutim Atë përmes lutjeve dhe Ai do t'u përgjigjet lutjeve tona, ndonëse mund të mos përgjigjet gjithmonë kur apo si ne dëshirojmë, sepse Ai e di më mirë çka është më e mira për ne më shumë sesa ne vetë.

## CILËSITË DHE VEÇORITË E ZOTIT (ALLAHUT)

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) ka thënë: *“Vërtet Allahu është i bukur dhe Ai e do bukurinë.”* (Sahihu Muslim)

Disa nga cilësitë dhe veçoritë që e dallojnë Zotin e vetëm të vërtetë (Allahun) nga ata që thonë (apo u referohen të tjerët) si Zoti janë këto:

- ❖ Zoti i vetëm i vërtetë (Allahu) është i veçantë në kuadër të cilësive të Tij. Asnjë nuk është si Ai dhe asnjë karakteristikë njerëzore apo e kafshëve nuk mund t'i cilësohet Atij.
- ❖ Ky Zot i vetëm i vërtetë (Allahu) është Krijuesi; Ai nuk është as i krijuar as i lindur.
- ❖ Zoti i vetëm i vërtetë (Allahu) na ka krijuar që ta adhurojmë vetëm Atë. Kur ne e adhurojmë atë në këtë mënyrë, ne lirohemi nga adhurimi i idhujve, i shenjtëve, figurave të famshme, parasë apo diçkaje tjetër.
- ❖ Zoti i vetëm i vërtetë (Allahu) është një, nuk ka tre të tillë apo më shumë! Ai nuk ka partnerë apo ndonjë shoqërues të barabartë me Të.
- ❖ Zoti (Allahu) nuk mund të shihet nga qeniet njerëzore apo nga krijesat e tjera në këtë jetë.
- ❖ Zoti nuk manifestohet apo rijetësohet në ndonjë formë fizike të krijesave të Tij.
- ❖ Zoti është i përjetshëm; Ai nuk vdes as nuk ndryshon.
- ❖ Zoti nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd, sikurse është nëna, gruaja apo djali; as nuk kërkon ushqim, pije apo ndonjë ndihmë të këtij lloji. Të tjerët janë ata që kanë nevojë për Të.

Ne mund t'i përdorim këto kritere dhe cilësi (si dhe të tjera që i përkasin vetëm Atij) që të bëjmë vlerësime apo qëndrime se dikush apo diçka është Zot.

## A JE ENDE KURESHTAR?

Nëse je kureshtar dhe i/e interesuar të zbulosh më shumë informata dhe detaje rreth Islamit, ju lutem vizito webfaqen tonë: [www.discoveritsbeauty.com](http://www.discoveritsbeauty.com)

Ndihuni të lirë të na dërgoni me e-mail pyetjet dhe kritikrat tuaja në: [info@discoveritsbeauty.com](mailto:info@discoveritsbeauty.com)

SERITË E 'ZBULOJE BUKURINË E TIJ  
NË 7 MINUTA'

WEBFAQET E DOBISHME ISLAME

- |                                                     |                                                                           |
|-----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| 1) Vetëm maja e ajsbergut                           | <a href="http://www.allahsquran.com">http://www.allahsquran.com</a>       |
| 2) Feja e Ademit dhe Havasë                         | <a href="http://www.quranexplorer.com">http://www.quranexplorer.com</a>   |
| 3) ABC-ja e Islamit                                 | <a href="http://www.islamhouse.com">http://www.islamhouse.com</a>         |
| 4) Përgjigje ndaj pyetjeve madhore të<br>njerëzimit | <a href="http://www.edialogue.com">http://www.edialogue.com</a>           |
| 5) Emrat e Tij të bukur                             | <a href="http://www.islamreligion.com">http://www.islamreligion.com</a>   |
| 6) Shpallja e fundit                                |                                                                           |
| 7) I Dërguari i fundit                              | <a href="http://www.newmuslimguide.com">http://www.newmuslimguide.com</a> |

## DËSHMIA E BESIMIT

### HYRJA NË ISLAM

*“Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”*

Në arabisht lexohet:

أشهد أن لا إله إلا الله  
وأشهد أن محمدا رسول الله

që në shqip tingëllon sikurse më poshtë:

ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,  
VE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULULLAH!

Kjo është dëshmia e besimit që duhet të deklarojmë në mënyrë që të përqafojmë Islamin; ajo përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.

Publikuar nga GLOBAL ACADEMY FOR TRANSLATION AND EDUCATION (GATE)  
LONDËR, MBRETËRI E BASHKUAR

[www.the-gate.co.uk](http://www.the-gate.co.uk)

[info@the-gate.co.uk](mailto:info@the-gate.co.uk)